Prej problemeve të mëdha mjedisore të lidhura me deponitë është shkarkimi i ujërave acide që rrjedhin nga deponitë në mjedis. Ndikimi më i madh ndotës i këtyre ujërave acide është në ujrë nëntoksore. Ndotja e ujërave është një rezultat i një procesi të transferimit të masave. Mbeturat që shkarkohen në deponi kalojnë në transformime biologjike, kimike dhe fizike të cilat janë të kontrolluara përmes faktorëve influencues të futjes së ujërave. Pra, ujrë acide të deponisë janë ujëra të ndotura me një kompleksitet të lartë ndotësish. Problemi i ujërave acide i shoqëron deponitë që nga fillimi i mbushjes dhe shumë vite pas mbylljes. Operimi i deponisë me kolektimin e ujërave acide (liksivateve) dhe trajtimin e tyre është bazë për një deponi të sigurtë dhe me sa më pak emisione.

2.6.3 Prodhimi i ujërave acide

Faktorët kryesor:

Disponueshmëria e ujërave

Karakteristikat e mbulimit përfundimtar

Karakteristikat e tipeve të mbetjeve

Metoda e papërshkueshmerisë

Bilanci hidrologjik

$$L = P + S + G + R^* - R + \Delta U_s + \Delta U_{\text{ë}} - ET$$

L – ujëra acide gjeneruese P - reshjet meteorologjike

S,G – infiltrimi në shtresë nga ujrë siperfaqësore ose nëntoksore

ΔU_s – ndryshimet e akumulimit të lagështirës në mbulesën e sipërme
ET – evapotranspirim konkret

R, R* - prurjet sipërfaqësore

$\Delta U_{\text{ë}}$ - ndryshimet e përmbajtjes së lagështirës në mbetje

$$R = C \times P$$

R- prurjet sipërfaqësore

C- koeficienti i prurjeve

P- intensiteti i shirave

$$C = a \times b$$

a – varet nga mbulimi final, nga llojet e materjaleve të përdorura dhe pjerrtësiab – varet nga lagështia e tokës në muaj të ndryshëm




Figura 2.18 Skema e një deponie

Në figurat 2.17, dhe 2.18 janë paraqitur 2 lloje të skemave të deponive njëra skem moderne ndërsa tjetra skemë e thjeshtë.

Tabela.2.1 Përberja e gazrave të një deponie

Gazrat	Shkalla e koncentrimin në %	
	Kufiri i ulët	Kufiri i sipërm
Metani	40	70
Dioksidi i Karbonit	30	60
Monoksidi i Karbonit	0	3
Oksigjeni	0	5
Azoti	0	3
Hidrogjeni	0	5
Sulfidet e Hidrogjenit	0	2
Gjurmët e gazrave	0	1

Në tabelen 2.1 përberja e gazrave të një deponie ku shkalla e koncentrimin është e ndarë në kufirin më të lartë dhe më të ulët.

2.6.4 Përbërsit e ujrave acide

Për ta stabilizuar gjendjen e pH-së ne impiantet e llumit aktiv dhe për të reduktuar përqëndrimin e larte te nitrateve ne efluentin e ujrave acide është e nevojshme të bëhet procesi i denitrifikimit. Shkalla e denitrifikimit varet nga sasia e ujit që riqarkullohet dhe masa e llumit si dhe nga raporti BOD5 – N. Që vlera e nitrateve në shkarkim të jetë më e ultë se (5-10) % e përmbajtjes se influentit është e nevojshme të bëhet riqarkullimi i masës. Proçesi para denitrifikimit do të ishte më i efektshem nëse do të kishte një përqëndrim më të lartë të lëndës organike të degradueshme në ujrata acide të pa trajtuara e cila mund të përdoret si substrat për bakteret denitrifikuese. Ka disa metoda të ndryshme të instalimit të puseve për nxjerrje të gazrave të deponisë. Këto mund të përfshijnë sistemin e përshkruar në dizajnin konceptual, sistemet horizontale të tubacioneve dhe puset e shpuara.

Parimi kryesor i minimizimit të emetimeve mjedisore është instalimi i një mbuloje të përkohshme të papërshkueshme, apo të mbivendosjes dhe restaurimit të tokës, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të mbajë një sistem aktiv të nxjerrjes së gazrave të deponisë. Vërehet se prodhimi i gazrave të deponisë nuk është përgjithësisht shqetësues gjatë vendosjes së mbeturinave duke dhënë kohë të mjaftueshme për krijimin e sistemit të nxjerrjes së gazit. Instalimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e sistemit të gazit të deponisë delegohet më së miri tek një kontraktues me përvojë, i cili mund të ketë preferuar detajet dhe sistemet e instalimit.

Gjithashtu, vërehet se ka mundësi që gazi i deponisë të hyjë në prodhimin e energjisë dhe të jetë i levërdishëm për një vend të kësaj madhësie. Dizajni ekzistues i sistemit të nxjerrjes së gazit ka disa mangësi që do të çojnë në vështirësi praktike gjatë operimit. Nuk rekomandohet që sistemi i kontrollit të gazit të deponisë të jetë miratuar tani apo të investohet shumë në blerje të paisjeve pa rishikim të mëtejshëm.

Referimi i parë përfshinte sigurimin e 2 njësive të flakës së gazit të deponisë për nxjerrjen e gazit, duke aplikuar vakum në një rrjet të tubave, dhe më pas djegien e gazit në një temperaturë të lartë. Secila njësi do të ketë një kapacitet prej 2.000 (m³/h), duke rekomanduar për një rishikim të kapaciteteve. Zakonisht sigurimi i njësive më të vogla portative prej 600 (m³/h), do të sigurojë fleksibilitet dhe aftësi më të madhe për të kontrolluar gazin e gjeneruar të deponisë në fazën e hershme

Përbërja e mbetjeve,

- pH,
- Potenciali i reduktimit të Oksigjenit,
- Moshë e vendgroposjes,
- Projektimi dhe menagjimi i vendgroposjes,
- Hidroliza e mbetjeve të ngurta dhe degradimi biologjik,
- Tretshmëria e përbërësve të tretësirave të kriprave në mbetje,
- Ndikimi pjesëzave të lëndës.

2.7 Opsionet për grumbullimin e mbetjeve të lëngëta

- Ndërtimi i pjesës së poshtme në formë të dhëmbëve të vendgroposjes
- Skarpate gjatësore (2 %)
- Pjerrtësia tërthore minimale prej (1 %)
- Përdorimi për vendgroposje vetëm i materialit kokrrizor – zhavor
- Poroziteti i lartë i shtresës drenazhuese
- Trashësia e shtresës së drenazhimit
> 50 cm Zhavor i pastër, me formë rrethore

Shpërndarja ajrore e drenazhimit, filtri duhet të mbulojë pjesën e poshtme dhe pjerresinë e vendgroposjes.

Kanale të ndara zhavori të përshtatshme për një shtresë drenazhimi me material të imët duhet të vendoset në një distancë prej 15 – 20 (m) dhe të ketë një gjersi minimale prej 2 (m).




Figura 2.19 Bllokimi i kanaleve të drenazhimit

Në figurat 2.19 është paraqitur bllokimi i kanaleve të drenazhimit kurse në figurën 2.20 vërehet se si mund te bëhet bllokimi i kanaleve te dranazhimit



Figura 2.20 Pamja e posit të grumbulluar të ujërave acide




Figura 2.21 Akumulimi i ujrave acide

2.7.1 Tubat e drenazhimit

Hapsirë e vogël ndërmjet tubave të drenazhimit 50 – 60 (m)

Vendosja paralele e tubave të drenazhimit

Diametri i tubit duhet të jetë më i madh se 200 (mm).

Tubat e drenazhimit duhet të kontrollohen me një videokamerë menjehere pas vendosjes.

2.7.2 Trajtimi i ujrave acide

Trajtimi i ujrave acide është esencjal për të reduktuar kryesisht komponentet organike dhe ato të azotit. Ujrat acide të deponisë janë ujra të ndotura me një kompleksitet të lartë ndotësish. Janë rezultat i proceseve biologjike, kimike dhe fizike që ndodhin në deponi. Metodatat e trajtimit të cilat mund të përdoren duhet të kenë parasysh prurjet e vogla dhe kompleksitetin e komponimeve, që i dallojnë ato nga ujrat e zeza dhe lloje tjera të ujrave të ndotura.

2.7.3 Cilësia e ujrave acide

Kryesisht janë dy faza që identifikohen në një deponi gjatë dekompozimit anerob të mbetjeve: faza acide (acidogjeneza) e cila shkakton një rënje të pH në ujrat acide, por gjithashtu shkakton një koncentrim të acideve organike dhe të joneve inorganike (Cl^- , SO_4^{2-} , Mg^{2+} , Ca^{2+} , Na^+), dhe faza e metanit (metanogjeneza). Liksiviatet e fazës acide karakterizohen nga një vlerë e lartë e BDO_5 ($>10.000 \text{ mg/l}$), nga një vlerë e lartë e raportit BDO_5/COD ($>0.7 \text{ mg/l}$) si dhe nga vlera e pH 5-6. Faza e metanit e degradimit anaerob karakterizohet nga një rritje e pH nga 6 deri në 8. Në këtë fazë ujrat acide karakterizohen nga një vlerë e ulët e BDO dhe e raportit BOD/COD, ndersa amoniakumbetet në vlera të larta.

2.7.4 Sasia e ujrave acide

Ujrat acide janë rezultat i precipitimit, rrjedhjeve sipërfaqësore, infiltrimit, kapacitetit të depozitimit të mbetjeve etj. Në shumë deponi normat vjetore të produktivitetit të ujrave acide janë zakonisht mes 12 % dhe 2 % i precipitimeve vjetore. Vlerat më të vogla se 18 % vijnë kryesisht nga deponit e reja.

Vlerësimi i cilësisë së ujrave të lumenjve dhe liqeneve dhe krahasimi i vlerave të parametrave kimike me normat përbën një nga kërkesat e në Direktivat e Bashkimit Evropian për monitorimin e gjëndjes së ujrave sipërfaqësore. Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve janë përdorur vlerat limite të përcaktuara në

Direktivën e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659, për cilësinë e ujërave të ëmbla për rritjen e peshqve dhe klasifikimi i cilësisë së ujërave të ëmbla natyrore sipas Institutit për Studimet e Ujërave të Norvegjisë – NIVA. Sipas këtij klasifikimi, parametrat e cilësisë së ujërave të ëmbla mund të ndahen në dy grupe:

1. në grupin e parë bëjnë pjesë ushqyesit, lëndët organike, përbërësit acide, grimcat e ngurta dhe bakteriet e fekaleve në ujëra.
2. në grupin e dytë metalet e rënda në nivelet mikro në ujë, sedimente dhe peshq. Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore.

KAPITULLI III

PJESA EKPERIMENTALE

3. Pjesa e punës

Puna e temës si dhe pjesa eksperimentale është kryer në laboratorin e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimo të Universitetit “ Isa Boletini “ në Mitrovicë. Kemi marrur gjithsej 2 mostra, në dy periudha kohore të ndara në muajin Qershor dhe i kemi analizuar. Gjatë analizave fiziko - kimike dhe punës kërkimore në ujërat grumbulluese, analizat të cilat i kemi bërë kemi përdorur kimikate të ndryshme dhe të nevojshme për përcaktimin e parametrave të shumtë në analizat e ujërave kulluese në deponinë e mbeturinave në Mitrovicë. Per realizimin kemi përdorur metodat bashkëkohore të përcaktimit të parametrave, si:

- metodën me hollim direkt,
- metodat standarde klasike të analizës,

ku marrja e mostrave është bërë pas një studimi të vendmostrimeve. Evidencë është mbajtur për marrjen e mostrave me qëllim që të mundësohet nxjerrja e përfundimeve në menyrë që të jemi më të saktë. Janë përdorur mjete dhe enë standarde për marrjen e mostrave.

Për përcaktimin e parametrave të mostrave të ujërave të deponisë së mbeturinave në Mitrovicë kemi përdorur këto aparatura dhe instrumente:

- ✓ Matjën e temperatures, Termometër.
- ✓ Matjën e përcjellshmërisë elektrike, Konduktometri
- ✓ Matjen e pH e kemi bërë me pH- metër,

Puna laboratorike si dhe ecuria e punës të monitorimit ujrave grumbullues në deponin “ Gërmova “ në Mitrovicë së pari është bërë marrja/përgatitja e mostrave pastaj përcaktimi i analizave fiziko-kimike.

3.1 Ecuria e punës

Duhet të bëhet me kujdes marrja e mostrës së ujit për analiza laboratorike, gjithnjë duke rrespektur rregullat. Marrja e mostrës është mbledhja dhe dërgimi i mostrave të ujit për analiza laboratorike. Mënyra e marrjes së mostrës është e rëndësishme po aq sa edhe analizat. Prandaj duhet kujdes maksimal që mostra mos të kontaminohet gjatë marrjes dhe transportit deri në laboratorin përkatës, pra:

Hapi i parë – marrja e 2 mostrave në pusët ujore në deponin “ Gërmova “ në Mitrovicë. Uji mirret në shishe të pastërta të cilat para mbushjes shpërlahet dy-tri here me të njëjtin ujë që do të mostrohet.

Hapi i dytë – Pas marrjes së mostrës, shishja mbyllet me tap, ku në to shenohet vendi i marrjes mostës, data, koha, temperatura e ujit dhe e ajrit.

Hapi i tretë – Dërgimi i mostrave në laborator për përcaktimin e analizave fiziko-kimike ku mostra për hulumtim janë marr dy here.

Tabela 3.1 Llojet e analizave të ujit.

Llojet e analizave:	Përshkrimi i analizës:
Era	Era në temperaturë të dhomës përcaktohet me nuhatje.
Shija	Përcaktimi bëhet atëherë kur nuk dyshohet në parametrat mikrobiologjik, toksikologjik të ujit.
Ngjyra	Ngjyra e ujit përcaktohet pas largimit të turbullsisë. Përcaktimi i ngjyrës mund të bëhet në mënyrë vizuale.
Temperatura	Përcaktimi i temperaturës bëhet me termometer i shkallëzuar në 0.10 °C.
Turbullira	Bëhet matja e dioksidit të silicit (SiO ₂) të shprehur në mg/dm ³ .
pH-ja	Përcaktimi i vlerës së pH bëhet me aparatura që quhen pH-metër.
Hargjimi i KMnO ₄	Paraqet sasinë e permanganatit që hargjohet për oksidimin e materieve organike që gjenden në ujë.
Nitritet	Vlera kufitare e matjes: 0.002-0.200 mg/l NO ₂ -N.
Nitratet	Vlera kufitare e matjes: 0.5-20.0 mg/l NO ₃ -N.
Përqeshmëria elektrike	Matja bëhet me aparatën e quajtur KONDUKTOMETËR.

3.1.1 Përcaktimi i erës dhe shijes

Era dhe shija janë tregues për praninë e kripërave minerale, materieve organike, mikroorganizmave si dhe gazrave të ndryshëm. Në disa raste era e ujit është e kushtëzuar nga prania e bimëve që jetojnë në ujë dhe nga mbeturinat që mbesin pas kalbjes së tyre.

Përcaktimi i erës: Në erlenmajer me vëllim 300 ml hidhen 100 ml të mostrës së ujit, mbulohet me xham të orës dhe vendoset në vaskën me ujë të ngrohtë. Kur të arrihet temperatura prej 40 °C ena hiqet nga vaska, largohet xhami i orës dhe mostra nuhatet menjëherë.

Shija e ujit në terren apo në laborator përcaktohet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Ky përcaktim bëhet vetëm atëherë kur nuk dyshohet në parametrat mikrobiologjik dhe toksik të ujit që do të thotë nëse përjashtohet mundësia e infektimit dhe mundësia e helmimit.

Përcaktimit i shijes: Shija e ujit vështirë mund të përcaktohet pas pirjes së duhanit apo pijeve alkoolike, personi i cili do të përcaktojë shijen e ujit organet respiratore duhet ti ketë të shëndosha, pra para përcaktimit të shijes nuk lejohet të merret ushqim sidomos ushqimet që kanë shije të ithët, të thartë, djegës ose çfarëdo lloji i ushqimit që ka shije të theksuar. Një gllënjë uji për hulumtim merret përmes gojës, qëndron pak në gjuhë dhe pastaj shpërllahet fyti dhe zgavra e gojës. Uji duhet të vlon rreth pesë minuta dhe pastaj ftohet shpejtë në temperaturë 25 °C.




Figura 3.1 Përcaktimi i erës dhe shijes.

3.1.2 Përcaktimi i ngjyrës

Në ujin e pijshëm ngjyra e ujit është indikatorë që njerëzit mos ta konsumojnë ujin. Ngjyra e ujërave rrjedhë nga prania e substancave humusore, komponimeve të hekurit, mikroorganizmave të ndryshëm, barishteve në afërsi të objekteve industriale, hedhurinave etj. Nëse rrjedhjet e lumenjve dhe sistemet akumuluese kalojnë përmes kënetave dhe moçaleve uji është i ngjyrosur.

Përcaktimi i ngjyrës: Bëhet në mënyrë vizuale me metodën krahasuese standarde duke përdorur komperatorin e Hellige-ut të pajisur me disqe. Rezultatet shprehen në shkallë Pt-Co në mg/dm^3 platin në formë të jonit platinat. Përcaktimi i ngjyrës në mënyrë është paraqitur në figurën vijuse:



Figura 3.2 Përcaktimi i ngjyrës në mënyrë vizuale

3.1.3 Përcaktimi i temperaturës

Përcaktimi i temperaturës bëhet me anë të termometrit të shkallëzuar në $0.10\text{ }^{\circ}\text{C}$. Temperatura e ujit është e rëndësishme për jetën e gjallesave në ujë ku kualiteti i ujit të puseve të thella shpesh përcaktohet vetëm me anë të matjes së temperaturës.

Mënyra e përcaktimit të temperaturës në ujë: Matja e temperaturës në ujë bëhet me zhytjen e termometrit në ujë. Pasi të arrihet vlerë e pa ndryshuar e temperaturës bëhet leximi i vlerës. Në të njëjtën kohë bëhet edhe matja e temperaturës së ajrit në afërsi të vendit të matjes së temperaturës së ujit por duhet pasur kujdes që të mos jetë nën ndikimin e çfarëdo burimi të nxehtësisë apo ndikimit të drejtpërdrejtë të rrezeve të diellit.



Figura 3.3 Përcaktimi i temperaturës përmes termometrit.

3.1.4 Përcaktimi i turbullirës

Me turbullirë nënkuptojmë zvogëlimin e dukshmërisë së ujit për shkak të pranisë së grimcave të suspenduara dhe koloide. Turbullira e ujit rrjedh nga grimcat e suspenduara të argjilës, lymit me origjinë inorganike, organike si dhe mikroorganizmave mikroskopikë. Në të shumtën e rasteve turbullira e ujit përcjellet me rritjen e numrit të bakterieve, gjë e cila ndikon në cilësinë e ujit të pijshëm.

Mënyra e përcaktimit të turbullirës në ujë: Metoda e përcaktimit të turbullirës bazohet në efektin e shpërndarjes së dritës që bëhet nëpër mostrën e ujit e cila përmban grimca koloide, emulsione. Intensiteti i dritës së shpërndarë është proporcional me turbullirën e tretësirës. Matja bëhet me turbidimetër, turbullira shprehet me njësi NTU (Turbiditeti Nefelometrik i Unisuar).



Figura 3.4 Përcaktimi i turbullirës përmes turbidimetrit.

3.1.5 Përcaktimi i pH-së

Te shumica e ujërave natyrore vlera e pH-së sillet prej 4.5 - 8.5 dhe këto vlera kushtëzohen me baraspeshën midis dyoksidit të karbonit dhe bikarbonateve në ujë. Uji i pijshëm ka karakter neutral deri te ai bazik (pH-ja = 7.0 - 7.4) për shkak të pranisë së karbonateve dhe bikarbonateve.

Përcaktimi më i saktë i vlerës së pH-së arrihet me matje potenciometrike me ndihmën e elektrodës së qelqit si elektrodë indikatore dhe elektrodës së ngopur të kalomelit. Ky sistem për matjen e pH-së bazohet në faktin se ndryshimi i vlerës së pH-së për një njësi shkakton ndryshimin e potencialit elektrik në 25 °C për 59.1 mV. Këtë përcaktim nuk e pengojnë turbiditeti, ngjyra, prania e materieve koloide si dhe substancave oksiduese dhe reduktuese.



Figura 3.5 Përcaktimi i pH-ës me pH-metër.

3.1.6 Përcaktimi i hargjimit të KMnO₄

Përcaktimi i shpenzimit të KMnO₄ shërben për përfitim të shpejtë të të dhënave mbi ndotjen e ujit me substanca organike të cilat mund të oksidohen. Mirëpo, edhe disa substanca inorganike si p.sh. Fe²⁺, H₂S etj. mund të oksidohen me KMnO₄. Prandaj, shpenzimi i KMnO₄ vetëm kushtimisht mund të konsiderohet si masë e përmbajtjes së substancave organike në ujë.

Mënyra e përcaktimit: 100 ml të mostrës së ujit për analizë vendosen në erlenmajer, pastaj i shtohet nga 5ml të H₂SO₄ (1:3) dhe nxehet gjer në pikë të vlimit. Kësaj tretje

i shtohet 15 ml KMnO_4 0.002M dhe e vlojmë për 10 min. Pas vlimit i shtohet 15 ml $\text{H}_2\text{C}_2\text{O}_4$ (acid oksalik) 0.005M me qëllim të ç'ngjyrosjes së ngjyrës së tretjes. Këtë tretje të ç'ngjyrosur e titrojmë me KMnO_4 0.002 M derisa të përfitohet ngjyra rozë e çeltë. Mililitrat e shpenzuar të KMnO_4 0.002M shumëzohen me faktorin 3.16 dhe ipet rezultati.



Figura 3.6 Përcaktimi i hargjimit të KMnO_4

3.1.7 Përcaktimi i nitriteve

Nitritet janë produkte biokimike të cilat paraqiten si ndërprodukte gjatë oksidimit të amoniakut deri në nitrate. Në ujë arrijnë nga mbeturinat e bimëve, plehurat azotike, ujërat e zeza, ujërat e ndotura industriale etj.

Kur nitritet mbërrijnë në lukth acidi klorhidrik që ndodhet në lukth i shndërron në acid nitror i cili vepron me aminat sekondare nga trakti digjektiv duke formuar N-nitrozaminat që janë të njohura si substanca kancerogjene. Në fund vlerat e fituara llogariten me faktorin ($f = 3.33$).




Figura 3.7 Përcaktimi i nitriteve.

3.1.8 Përcaktimi i nitrateve

Nitratet në ujë arrijnë nga disa burime si p.sh. nga atmosfera, mbeturinat e bimëve, ekstremitetet e shtazëve, plehurat azotike, ujërat e zeza, ujërat e ndotura industriale si dhe nga materiet organike që i nënshtrohen zbërthimit përmes aktiviteteve bakteriale. Meqenëse kanë tretshmëri të lartë lehtë arrijnë në ujë përmes tokës. Sasia e përgjithshme e azotit në ujin e pijshëm më e lartë se 10 mg/dm^3 shkakton sëmundjen e methemoglobinemisë tek fëmijët. Vlerat e fituara llogariten me faktorin ($f = 4.43$).



Figura 3.8 Përcaktimi i nitrateve.

3.1.9 Përcaktimi i përqeshmëris elektrike

Njësia specifike merret përqeshmëria e tretësirës ujore me sipërfaqe 1 cm^2 dhe gjersi 1 cm , dhe njësia është mikrosimens për centimeter. Uji i pastër kimikisht ka përqeshmëri elektrolitike të vogël. Përcjellshmëria e rrymës elektrike e shkaktojnë krypnat e tretur në ujë, acide dhe baza. Këtë përqendrim të këtyre joneve i quajmë elektrolit. Matja bëhet me aparatin e quajtur Konduktomtër. Përcaktimi i përqeshmëris elektrike përmes konduktometrit është paraqitur në figurën vijuse:



Figura 3.9 Përcaktimi i përqeshmëris elektrike përmes konduktometrit.

Tabela 3.2 Vlerat referente sipas Direc.98/83/EC.

Parametrat	Njësia	Vlerat referente Direc.98/83/EC
Temperatura	°C	8-12
Aroma	--	Pa
Shija	--	Pa
Ngjyra	--	Pa
Turbullira	NTU	1.2-2.4
pH	--	6.5-8.5
Shpenzimi i KMnO ₄	mg/l	8-12
Nitritet	mg/l	0.005
Nitratet	mg/l	10
Përqueshmëria	ms/cm	1500
Potenciali	milvolt	20 - 28
TDS	g/l	15 - 25

Tabela 3.3 Rezultatet e analizave të mostrës së patë

Parametrat	Njësia	Direc.98/83/EC	Mostra e parë
Temperatura	°C	8 - 12	19.4
Aroma	--	Pa	e keqe
Shija	--	Pa	e keqe
Ngjyra	--	Pa	e keqe
Turbullira	NTU	1.2 - 2.4	11.9
pH	--	6.5 - 8.5	7.68
Shpenzimi i KMnO ₄	mg/l	8 - 12	5.57
Nitritet	mg/l	0.005	4.0
Nitratet	mg/l	10	9.4
Përqueshmëria	ms/cm	1500	627
Potenciali	milvolt	20 - 28	31.3
TDS	g/l	15 - 25	12.23

Tabela 3.4 Rezultatet e analizave të mostrës së dytë

Parametrat	Njësia	Direc.98/83/EC	Mostra e dytë
Temperatura	°C	8-12	22.3
Aroma	--	Pa	e keqe
Shija	--	Pa	e keqe
Ngjyra	--	Pa	e keqe
Turbullira	NTU	1.2-2.4	12.2
pH	--	6.5-8.5	7.86
Shpenzimi i KMnO ₄	mg/l	8-12	5.76
Nitritet	mg/l	0.005	4.2
Nitratet	mg/l	10	9.7
Përqueshmëria	ms/cm	1500	679
Potenciali	milvolt	20 - 28	33.2
TDS	g/l	15 - 25	13.57

KAPITULLI IV

4 DISKUTIMI I REZULTATEVE

Në pjesën eksperimentale, gjatë hartimit të këtij punimi, janë marrë gjithësej 2 mostra të ujit nga uji kullues në deponin “ Gërmova “ në Mitrovicës. Nga rezultatet e fituara është bërë vlerësimi i gjendjes të cilësisë së ujit kullues në deponin “ Gërmova “ në Mitrovicës , dhe si vlera bazë e referente janë marrë ato që dalin nga Direktiva 98/83/EC për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Për sa i përket aspektit organo - leptik uji ka qenë në suaza të këqija edhe në ujin e papërpunuar por edhe në ndikimit të keq në mjedis. Si për aromë, shije dhe ngjyrë vërehet tejkalim dhe ndikim në mjedis. Në mostrën e parë dhe në mostrën e dytë dhe gjatë analizave në ujin e papërpunuar turbiditeti ka kaluar shumë herë kufijt e lejuar, siç është thënë më lartë për shkak të pranisë së materieve organike në ujë ose grimcave të suspenduara. Për sa i përket ujit i përpunuar të gjithë parametrat janë brenda kufijëve të lejuar, me përjashtim të potencialit të lirë, mirëpo kjo nuk është aq një vlerë alarmante ose shqetësuese. Ndërsa shpenzimi i KMnO_4 është nën vlerat referente . Shkencërisht është e ditur se si rezultatet i pranisë më të lartë të materieve organike në ujë shpenzohet më shumë permanganat kaliumi (KMnO_4) për oksidimin e tyre, vlera e këtij parametri shifet ma e madhe te mostra e dytë se ajo nga mostra e parë. Në ujin e përpunuar, të analizuar në këtë hulumtim, të gjithë parametrat janë brenda kufijëve të lejuar, kurse te Nitritet vlera e saj është shumë here e tejkaluar (alarmante) si dhe Nitratet gjithashtu disa here e tejkaloin nga parametrat e lejuara. Në mostrën e parë të analizimit të gjithë parametrat organo - leptik por edhe fiziko - kimik në ujin kullues në deponin “ Gërmova “ në Mitrovicës kanë vlera deridiku në përputhje me vlerat referente. Mirëpo turbiditeti i ujit të papërpunuar në sasi fare të vogël e kalon vlerën referente, për shkak të pranisë shumë të vogël të materieve organike ose grimcave të suspenduara në ujë.

KAPITULLI V

5 PËRFUNDIMI

Uji është një burim mjaftë i rëndësishëm për zhvillimin e të gjithë organizmave përfshirë edhe njeriun. Faktori njeri është vazhdimisht duke e degraduar natyrën gjë që shpie në vështirësin e jetës së tij. Kujdesi për ujin duhet të jetë maksimal pasi që ai është një faktor esencial për zhvillimin e veprimtaris së njeriut dhe shëndetin e tij. Përdorimi i vazhdueshëm dhe i pakontrollueshëm i plehrave artificiale dhe pesticideve, menaxhimi jo i mirë i mbeturinave na shpie edhe deri te ndotja. Në bazë të këtij hulumtimi, nga rezultatet e fituara gjatë punës laboratorike, parametrat tregojnë se cilësia e ujit është mjaftë e dyshimt në të dy rastet edhe në ujin e ,papërpunuar por edhe në ujin e përpunuar. Duke u bazuar në hulumtimet e kryera rreth ujrave grumbulluese në deponinë e mbeturinave në Mitovicë, konkludojë se nga analizat fiziko – kimike dhe metodave organo - leptike të realizuara në muajin Koik, është konstatuar se ujrata e grumbulluara janë me parametra të lartë ndotës, me tendencë të keqësimit të mëtutjeshëm.

Analizat e mostrave të ujërave nëntokësore për pusët pranë deponive dhe ujërave të kulluara dhe akumuluar duhet të bëhen vazhdimisht sipas standardeve të parapara kohore. Trajtim i centralizuar i ujërave të kulluara me një impiant trajtues vetëm për deponi. Të ketë një vazhdimësi hulumtuese dhe operative brenda deponisë edhe në të ardhmen në periudha më të gjata kohore si pikë studimi për brezat e rinjë shkencor.

CONCLUSION

Water is a very important resource for the development of all organisms, including humans. The human factor is constantly degrading nature, which leads to the difficulty of his life. The care for water should be maximum since it is an essential factor for the development of human activity and his health. The continuous and uncontrollable use of artificial fertilizers and pesticides, poor waste management leads us to pollution. Based on this research, from the results obtained during the laboratory work, the parameters show that the water quality is quite questionable in both cases, both in the raw water and in the processed water. Based on the research carried out about the collected waters in the waste dump in Mitovicë, it is concluded that from the physical-chemical analyzes and organo-leptic methods carried out in the month of Koik, it has been established that the collected waters have high polluting parameters, with a tendency of further deterioration.

Analyzes of groundwater samples for wells near landfills and drained and accumulated water should be done continuously according to the predetermined time standards. Centralized wastewater treatment with a landfill-only treatment plant. To have a research and operational continuity within the landfill even in the future in longer periods of time as a point of study for the new scientific generations.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Korça B. (2002), “Analiza kimike e ujit”, WUS Austria, Prishtinë.
- [2] Çulaj A. (2003), Kimia e Mjedisit, Tiranë.
- [3] Daci N., “Kimia e mjedisit: Ndotja industriale - parandalimi” Prishtinë, 1998.
- [4] <http://www.lamotte.com/en/blog/test-factors/91-what-is-turbidity> (20.08.2017)
- [5]<http://www.fondriest.com/environmental-measurements/conductivity-salinity-tds/>
(21.04.2021)
- [6] Weerts A.H. (1994) Analytical models for chemical transport on the subsurface environment, Deltares.
- [7] <https://www.iberdrola.com/sustainability/water-pollution> (08.05.2021)
- [8]<https://www.onlinebiologynotes.com/physical-parameters-of-water-quality-physical-characteristic-of-water/> (24.05.2020)
- [9] <https://readcivil.com/types-of-coagulants-used-in-water-treatment-process>